



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 131 prot.
6

Tiranë, më 22.2026

V E N D I M
Nr. 3, datë 2.2.2026

PËR
PUBLIKIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË, TË CILËT KANË
KALUAR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS NGA
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Pas verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe pas miratimit të listës së kandidatëve magjistratë që pranohen në Shkollën e Magjistraturës në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të nenit 248, 266 të ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të nenit 53 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", nenit 32, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar", vendimit nr. 875, datë 23.12.2025, "Për kualifikimin e kandidatit z. **K E** për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2024-2025" të Këshillit të Lartë Gjyqësor; vendimit nr. 382, datë 23.12.2025, "Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2025-2026, znj. **J Z**" të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 2.2.2026,

V E N D O S I:

1. Të publikojë listën e kandidatëve për gjyqtar, prokuror 2025-2026, të cilët kanë kaluar me sukses procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë sipas listës bashkëngjitur pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES**

**LISTA E KANDIDATËVE PËR GJYQJAR
NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR
NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS
PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026,
MIRATUAR NGA KLGJ-JA, PAS VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS**

Nr.	Emër Mbiemër	Profili	Data e miratimit
1.	K F	Kandidat për gjyqtar	23.12.2025

**LISTA E KANDIDATËVE PËR PROKUROR
NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR
NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS
PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026,
MIRATUAR NGA KLP-JA, PAS VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS**

Nr.	Emër Mbiemër	Profili	Data e miratimit
1.	J Z	Kandidat për prokuror	23.12.2025